

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	FOTO/ Brenda shtëpisë së Adnan Sami-t, koleksioni i rrallë që bashkon Michael Jackson, Beatles dhe Beethoven
ADRESA	https://www.gazetatema.net/lifestyle/foto-brenda-shtepise-se-adnan-sami-t-koleksioni-i-rralle-qe-bashkon-mi-i588087
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 10:33:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 10:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d836934a040a1a3bf1b315d5a1e607b392be11bd91bad8b4d502c36f18216043
TEKSTI	91391081566525fb9999d1676606655c83ffdf3e6692fd682fce7f8b9eaab9d0
PAMJA	3fb4e0d473ead1aaa54c49d46aa85ed02b82a6b58c0098e4fb9bf150ac77ab15

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d63c7d593f43bb29a0d84297cfbcfe64dfe971103934a30a649af3906d06fe8c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	34bf9fb855e0215b8384019a592b192cd8415b3fea3e8d3a2dd71c749e8b79fe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d63c7d593f43bb29a0d84297cfbcfe64dfe971103934a30a649af3906d06fe8c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie FOTO/ Brenda shtëpisë së Adnan Sami-t, koleksioni i rrallë që bashkon Michael Jackson, Beatles dhe BeethovenShqiperi-Bjellorusi, gjykon nje anglezVIDEO/ Kreu i SHIS fundit

FOTO/ Brenda shtëpisë së Adnan Sami-t, koleksioni i rrallë që bashkon Michael Jackson, Beatles dhe Beethoven



24 Shtator 2026, 12:30Lifestyle TEMA



Shtëpia luksoze e këngëtarit dhe kompozitorit Adnan Sami në Mumbai nuk është thjesht një rezidencë me ambiente të mëdha dhe arredim luksoz. Brenda saj ndodhet një koleksion i veçantë muzikor, me disqe, instrumente dhe objekte që lidhen me disa prej emrave më të mëdhenj të historisë së muzikës.

Pamjet nga apartamenti i tij u publikuan së fundmi nga regjisorja Farah Khan, duke zbuluar një hapësirë ku muzika duket se është pjesë qendrore e arredimit.

Në koleksionin e Sami-t ndodhen disqe origjinale të emrave të njohur si The Beatles, Michael Jackson dhe Elvis Presley, ndërsa një prej objekteve më të rralla është një dorëshkrim muzikor origjinal i lidhur me Ludwig van Beethoven.

Sipas The Indian Express, bëhet fjalë për një dorëshkrim të "Moonlight Sonata", një prej veprave më të njohura të kompozitorit gjerman. Dorëshkrime të tilla të Beethoven-it janë shitur në ankande për shifra që arrijnë në miliona dollarë, duke i dhënë koleksionit një vlerë të jashtëzakonshme historike dhe artistike.

Por koleksioni nuk përfundon te Beethoven-i. Në ambientet e banesës janë ekspozuar edhe instrumente, antikitet dhe materiale të tjera të lidhura me muzikën, ndërsa Sami ka krijuar edhe një studio private muzikore.

Pamjet e publikuara nga Farah Khan treguan një pjesë të kësaj hapësire dhe sollën në vëmendje mënyrën se si këngëtari ka ndërthurrur pasionin për muzikën me jetën e tij private.

Shtëpia, e vendosur në zonën Lokhandwala të Mumbait, është përshkruar nga mediat indiane si një penthouse luksoz, por ajo që e veçon është pikërisht koleksioni i objekteve muzikore që Sami ka zgjedhur t'i mbajë të ekspozuara.

Në vend që këto kujtime të ruhen larg syve, ato janë bërë pjesë e hapësirës së banimit, duke e kthyer apartamentin në një lloj "muzeu muzikor" privat.

Përveç objekteve të lidhura me muzikën ndërkombëtare, në koleksionin e tij gjenden edhe materiale që lidhen me historinë e muzikës indiane.

Adnan Sami është një prej këngëtarëve dhe pianistëve më të njohur në Indi dhe ka një karrierë disa dekadëshe në muzikë. Pasuria e tij muzikore duket se nuk kufizohet vetëm te këngët që ka realizuar vetë, por edhe te koleksioni i objekteve historike që ruan në shtëpinë e tij.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Japonia thyen rekordin, mbi 100 mijë persona kanë mbushur 100 vjeç - 88% janë gra](#)

Djemtë e ish-krerëve të UÇK-së bëhen kryefjalë në rrjet, Endrit Thaçi dhe Klestor Veseli në qendër të kërkimeve në Google

10:49 Lifestyle

Melania Trump flet si rrallëherë për Trump: "I them gjithmonë të vërtetën, edhe pse ndonjëherë nuk i pëlqen"

09:40 Lifestyle

Pas vdekjes së Dolly Parton plas sherri për trashëgiminë saj, menaxheri akuzon nipin e këngëtares për kërcënime

09:00 Lifestyle

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.